



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2732/11 prot.

Datë, 11.11.2025

V E N D I M
Nr. 1645/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.11.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1568/2025, datë 31.10.2025 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur e thjeshtuar - Shërbime”, me nr. REF-55339-07-17-2025, me objekt “Shërbim interneti për nevojat e SHRUKD”, me fond limit 7,800,000 (shtatë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 18.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “Vodafone Albania” sh.a me Nipt K11715005L dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga “Pavarësia” nr.61, Kashar, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sha.
L.17, Rruga “Dalip Peza”, Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për

Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 31.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1568/2025, ku vendosi:

“[....]

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Vodafone Albania” sh.a për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar - Shërbime”, me nr. REF-55339-07-17-2025, me objekt “Shërbim interneti për nevojat e SHRUKD”, me fond limit 7.800.000 (shtatë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 18.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a..
1. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomikë ankimues Vodafone Albania” sh.a, duke e kualifikuar atë.
2. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
2. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar operatori ekonomik të paguar nga operatori ekonomik “Vodafone Albania” sh.a .
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [....]”

I.2. Me shkresën nr. 2342/43 prot., datë 27.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2581/6 prot., datë 28.10.2025 autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1568/2025, datë 31.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin për rivlerësimin e procedurës së prokurimit në system.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2342/43 prot., datë 27.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2581/6 prot., datë 28.10.2025 autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1568/2025, datë 31.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin për rivlerësimin e procedurës së prokurimit në sistem.

II.2.Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar operatorin ekonomikë “Vodafone Albania “sh.a në përputhje me vendimin e KPP Nr. 1568/2025, datë 31.10.2025

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar - Shërbime”, me nr. REF-55339-07-17-2025, me objekt “Shërbim interneti për nevojat e SHRUKD”, me fond limit 7.800.000 (shtatë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 18.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a..
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

